

20 ambiente të lira

1 Mjet transporti (ambulancë)

Shërbimi Spitalor.

80 personel

8 autombulanca në gadishmëri 24 orë

294 shtretër për rastet e emergjencave civile.

150 Amjente te lira per evakuim

2 Laborator

Bashkia :

60 punonjës. 5 mjete transporti, 1 mjete vetshkarkues, 1 eskavator, 1 fadrom, 1 vinç, 1 autobot

Subjektet private për rrugët :

Drejtoria Rajonael e Rrugëve nacionale Dibër disponon:

N/	Sektori Rrugor Rural dhe	Borë	J.K.B.	Grejder	Kamionë	Kamionçinë	punonje s
R	Firmat kontraktuese	pastruese	Fadroma			mjet	
1	SHEHU sh.p.k	3	3	2	1		21

Shërbimi Shëndetësor:

Në shkallë Bashkie është kjo strukturë shëndetësore e cila do të shërbejë për raste të emergjencës.

Spitali Civil	1
Spital Infektiv	1
Spital Obsetrik Gjinekologjik	1
Kapaciteti me shtretër	294
Qendra Shëndetësore	17
Ambulanca	9

Personeli mjekësor është i specializuar (kapak në numër) për spitalin Dibër për të bërë ndërhyrje kirurgjikale.

Furnizimi me ujë të pijshëm

Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm kryhet nga:

Sh.a Ujësjiellësi Dibër për Bashkinë e Dibrës.

Ujësjiellësi i Bashkisë të Dibrës,e bëjnë furnizimin me ujë të popullatës me rrjedhje të lirë,

Nga Sh.a Ujesjiellësa-Kanalizime,punohet për masat e nevojshme për periudhën dimërore e verore, me qëllim sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm të popullatës.

Janë marrë masat për furnizimin me mjete ngrohëse dhe me materiale dizinfektue se të ujit të pijshëm për periudhën dimërore.

Problematiche mbetet rrjeti i amortizuar i Ujësjellësave e gjendja e mjeteve dhe pamundësia financiare për të ndërhyrë.

Furnizimi me energji elektrike.

Furnizimi me energji elektrike në Bashkinë e Dibrës bëhet nga OSHEE:Njësia Dibër.

Për problemet e arsimit

Në kushtet e Emergjencës Civile Dimërore mund të bëhet bllokimi i aktivitetit të mësimdhënies në shkolla si më poshtë:

Bashkia Dibër

Për përballimin e situatës dimërore nga drejtoritë e shkollave në bashkëpunim me organet vendore, për periudhën dimërore janë marrë masat, për furnizimin me lëndë ngrohëse të objekteve shkollore.
-Në rast bllokimi total të këtyre rajoneve në zbatim të akteve normative, me propozim të drejtorit të shkollës apo organit vendor nga Zyrat Vendore Arsimore, nxirret urdhëri për pezullimin e mesimdhënies për një periudhë 2 javore për ciklin 9-vjeçare 2 javore për shkollat e mesme.

Me nxjerrjen e këtij urdhëri njoftohet menjëherë Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve.Kjo periudhë mësimdhënie do të zëvendësohet në periudhën e verës.

Në rast se kjo periudhë e emergjencës dimërore do të zgjasë mbi këto kufij,atëherë do të organizohet mësimdhënie me grupe mikse të nxënësve me mësues sipas fshatrave.

I. SKENAR PËR QËLLIME PLANIFIKIMI.

-Në muajin dhjetor dhe në vazhdim kushtet klimaterike nga reshjet e shiu të dobëta u kthyen në reshjetë shumta dëbore ku u përfshi i gjithë rajoni i Bashkisë Dibër. Lartësia e reshjeve të dëborës variojnë nga 20-120 cm.

-Në akset Rrugore nacionale, kemi rënje inertesh gurëshe rrëshqitje të skarpatave, të cilat kanë bërë bllokimin e përkohshëm të disa akseve.

-Automjete udhëtarësh kanë dalë nga rruga për pasojë janë dëmtuar disa shtetas nga të cilët edhe në gjëndje të rëndë.

Aktualisht ka rezerva ushqimore, por sipas informacionit që kemi 30% e fshatrave të Njësive Administrative pas një periudhe 7 ditore do të kenë probleme ushqimore.

Erërat me drejtim nga Veriu kanë filluar të shkaktojnë probleme te para në drejtim të dëmtimit të linjave të furnizimit me energji të Bashkisë, ku kemi dëmtime të rrjetit transmetues të energjisë e për pasojë ka patur mosfurnizim me energji të njësive Lurë, Selishte, Kala e Dodës, Zall Dardhë, Reç.

Janë dhënë sinjale te para të ngrirjes së tubacioneve të furnizimit me ujë të pijshëm në qytetin e Peshkopisë.

Bllokimi i tubacioneve mund të jetë i pjesshëm në segmente të veçantatë të cilat janë në afërsi të sipërfaqes së tokës.

Ky fenomen është evident për linjat dytësore.

Temperaturat e sidomos ngricat bëjnë të domosdoshëm sigurimin në vazhdimësi të rrymës elektrike .

Dëmtimi i linjave të furnizimit me energjinë elektrikenë:

Kala e Dodës-Peshkopi, Kala e Dodës-Sllovë, Zalldardhw,
ZallaReç, Lurë e Selishtë,

POPULLSIA NË RREZIK:

Bashkia Dibër Nj.Adm. Selishtë :Fshatrat Kaeni, Selishë, Lukan, Qafë Murrë

Nj.Adm.Luzni:Fshatrat:Katundi i Ri,Hoteshe,LishaniPoshtëm,Lishani Sipërm,Arap i Sipërm, Arap i Poshtëm

Bllokimi total i popullsisë së Bashkive:

Nj.Adm. Melan: Fshatrat :, Cerjan, Rabdisht, Zagrad, Ilnice, Bellovë,

Nj.Adm. Tomin :Fshatrat: Bahute, Shimçan,Zimur.

Nj.Adm. Lurë : Fshatrat:Lurë, Borie Lurë, Arth, Gurë Lurë, Lurë e Vjetër, Arrmollë,KrejLurë, Pregjë Lurë, Sumej, Vlashaj.

Nj.Adm.Reç:Fshatrat:ZallReç,BardhajReç,DrajReç,GurReç,HurdhëReç,KrajReç,Ndërshenë,Qafdraj, Tharkë.

Nj.Adm. Arras: Fshatrat :Guri i Zi, Lazrej, Kodër Leshaj, Mustafe, Sinë e Sipërme, Sinë e Poshtme, Çidhën, Grykë Nokë.

Nj.Adm.Zall Dardhë:Fshatrat: Zall Dardhë,Lashkizë,Lugjej,Menesh,Nezhaj,Qa,Soricë,Shënllëshën, Tartaj.

Nj.Adm..Kala e Dodës;Fshatrat;Ceren,Kullas,Ploshtan,Radomirë,Shullan,Tejzë,Ujëmirë,Vasie.

IV.ORGANIZIMI PËRGJEGJËSITË E BASHKËPUNIMI:

a.Shërbimet që do të përfshihen në kushtet e emergjencës do të

jenë:Sektori i Rugëve Nacionale

Drejtoritë e Rugëve Rurale në bashkitë Dibër,

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik,

Komisariati Vendore i Policisë së Shtetit

Drejtoria Vendore e Policisë Kufirit dhe Migracionit

MZSH-të

Ujësjiellësit Dibër

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Durrës

Kryqi i Kuq dega Dibër me degët :

Autoriteti Rrugor Verior Shkodër

Biznesi Privat

Komuniteti

Media

Shërbimi Sinoptik

Puna që do të bëjnë :

Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër do të bëjë planizimin për organizimin e punës për mbajtjen në gadishmëri të akteve nacionale.

Prioritet kryesor do të ketë aksin Topojan-Peshkopi dhe Peshkopi-Kala e Dodës,.

Me strukturat e saj nëpërmjet Firmave Kontraktore do të ndërhyhet në rastet e fatkeqësive (bllokime, shembje të rrugëve) për të rivendosur gjendjen.

Do të monitorojë gjatë gjithë kohës aktivitetin e firmave kontraktore të cilat kanë akseset rrugore nacionale.

Me mjetet që kanë në dispozicion do t'i japë ndihmë strukturave të akseve rrugore në bashki në momentet që do të kërkohej nga Komisioni i Emergjencës Qarkut.

Bashkitë do të planizojnë në aktivitetin e saj, për mbajtjen në gadishmëri të rrugëve rurale duke realizuar lidhjen e Njësive Administrative me qendrat e bashkive.

Bashkia të bëjë vlerësimet e përlllogaritjet në mënyrë të vazhdueshme të gjendjes së ushqimeve të domosdoshme, vijueshmërinë e furnizimit me ushqimet bazë të popullatës. Gjëndjen e blegtorisë dhe masat e marra për rezervat e bazës ushqimore për sezonin dimëror.

Bashkia do të mbajë në vëzhgim objektet me rrezikshmëri duke marrë masat përkatëse për sinjalizim dhe evakuim të popullatës në bashkëpunim me organet vendore.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit gjatë gjithë kohës do të ushtrojë kontroll mbi cilësinë e ushqimeve si ato që tregëtohen si dhe ato që konsumohen. Nën vëmendje të veçantë do të ketë mallrat që vijnë nga jashtë e kontrollin e cilësisë së ndihmave ushqimore.

Drejtorita e Shëndetit Publike, Spitali do të jenë në gadishmëri për përballimin e emergjencave shëndetësore si në shërbimet spitalore deri tek qendrat shëndetësore.

Krijimin e rezervave me medikamente shëndetësore si në shërbimet spitalore deri tek qendrat shëndetësore.

Nga spitalet të mbahet në gadishmëri 30 shtretër për përballimin e fatkeqësive të cilat mund të shkaktojnë dëme në njerëz.

Të mbahet në gadishmëri të plotë reparti i urgjencës me llogjistikën e nevojshme.

Komisariati Vendore i Policisë së Shtetit, do të mbajë nën kontroll rendin e qetësinë publike në shkallë territori dhe do të japë kontributin e saj në mjete dhe njerëz në raste fatkeqësish.

Të marrë nën kontroll territorin në të cilin ndodh fatkeqësia duke marrë pjesë drejtëpërdrejtë në operacionet e ndërhyrjes.

Do të mbajë në kontroll të vazhdueshëm akseset rrugore duke ushtruar kontrole të vazhdueshme për levizjen e mjeteve të komunikacionit.

DMR(Detashmenti i Monitorimit Rajonal të F.A): Do të marrë pjesë në operacionet e shpëtimit dhe ato humanitare me mjetet dhe forca në situatën e emergjencës.

Bordi i Kullimit do të mbajë nën vëzhgim objektet me rrezikshmëri duke marrë masat përkatëse për sinjalizim dhe evakuim të popullatës në bashkëpunim me organet vendore.

OSHEE në shkallë Bashkie do të mbajë në gadishmëri rrjetin me furnizim të energjisë të popullatës në marrjen e masave në eliminimin e avarive që mund të ndodhin.

Sh.a Ujësjelles: do të mbajnë në gadishmëri linjat me furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës të prekur nga fatkeqësia duke ndërhyrë me grupet e gadishmërisë, për eliminimin e emergjencave në këtë shërbim publik.

MZSH-së do të marrin pjesën e veprimtaritë e kërkim shpëtimit në ato rajone ku ka fatkeqësi.

Kryqi i Kuq Rajonal si partner kryesor, do të bashkërendojë punën me komisionin e emergjencës në shkallë Bashkie për të vepruar në veprimtaritë humanitare.

Rezervat Materiale të Shtetit, bëjnë programimin e punës për krijimin e shpërndarjen e rezervave materiale në zonat e prekura nga fatkeqësitë.

Tatim-Taksat do të ndjekin me përgjegjësi e kontroll të rreptë të abuzuesve të çmimeve kryesisht atyre ushqimore.

Drejtoria Rajonale Doganore punon për lehtësimin e procedurave doganore për rastet e dhënies së ndihmës nga jashtë.

Biznesi privat do të punojë për krijimin e rezervave logjistike në përballimin e fatkeqësive.

Shërbimi sinoptik do të japë dy herë në ditë informacion për situatën sinoptike.

Me median do të koordinohet puna për pasqyrimin e aktiviteteve të shërbimeve e sensibilizimin e opinionit publik në përballimin e fatkeqësive.

C. PËR BASHKËPUNIMIN ME BASHKITË FQINJË.

Organizimi i bashkëveprimit ndërmjet Bashkive realizohet kryesisht me bashkinë e Kukësit, bashkinë e Bulqizës, bashkinë e Burrelit, Bashkinë e Mirditës dhe një pjesë të njësive me Maqedoninë Veriut që janë fqinjë përgjatë kufirit shtetëror, për veprimet të përbashkëta e ndihmë të ndërsjellta.

Për transportimin e të sëmurëve në Qendrën Spitalore Peshkopi.

Po i njëjti bashkëveprim do të realizohet me komunën e Dibrës së Madhe Maqedoni e Veriut për Njësitet Administrative të Dibrës.

Bashkëveprimi do të jetë me të gjithë fqinjët për dhënie e marrje informacioni.

a. Anetarët e Komisionit të Mbrojtjes Civile të Bashkisë Dibër.

- Rahim Spahiu	Kryetari Bashkisë	Kryetar
- Lorenc Cibaku	Nënkryetar Bashkie	Zv. Kryetar
- Sajmir Kojnozi	Nënkryetar Bashkie	Anëtar
- Hazbi Kamberi	Drejtori PPECK	Anëtar
- Altin Lila	Shefi Kom. Dibër	
- Ismet Saraçi	Drejtori Juridik Bashkia Diber	“
- Fatos Gjoka	Drejtori MZSH	“
- Bedri Kamberi	Drejtor i Shërbimeve Publike“	
- Çeljeta Zuna	Drejtori Ekonomik	“
- Ervis Manga	Drejtori Urbanistikës	“
- Agron Cara	Drejtori Bujqësisë	“
- Bajram Kalia	Drejtori Doganës Bllatë	“
- Lediana Gjoka	Zyra Vendore Arsimore	“
- Ruzhdi Deda	Drejtor i Spitalit Peshkopi	“
- Hajredin Cena	Përgj.Sektorit Ujsjellës Dibër	“
- Majlinda Hoxha	Ëord Vision	“
-Anisa Xhika	Drejtori Shëndetit Publik	“
-Avdi Hoxha	P.Sekt.Sektorit OSHE Dibër	“
-Kimete Mazari	Kryqi Kuq Dibër	“
-Rafaela Kaloshi	Drejtorja ISKSH	“
-Endri Deda	Përgjegjësi Policisë Bashkiake	“
-Ramazan Tema	Sekretari Komisionit MC	“

-Donald Ademi
-Administratorët

Koordinatori Nj.Administrative
sipas njësive

“

SKENARËT E RREZIKUT

Identifikimi i Riskut

Rreziqe prezente nw territorin e Bashkisw Dibwr

Rreziqet nga dëbora.

Rreziqet nga zjarret.
Rreziqet nga rrëshqitjet e tokës.
Rreziqet nga Përmbytjet.
Rreziqet sizmike .
Rreziqet nga aktet terroriste.

Rrëziqet nga dëbora:

Është rrëziku periodik vjetor që përfshin Bashkinë e Dibrës.

Bashkia e Dibrës është e vendosur kryesisht në zonën e klimës mesdhetare, paramalore dhe malore, nën zona veriore dhe lindore.

Minimumi absolutë është shënuar në Dibër me 27 janar 1963 ku ka arritur vlerat – 27 gradë C. Në stinën e dimrit pjesa më e madhe e reshjeve bie në formë dëbore, që fillon nga muaji Tetor, Nëntor deri në fund të muajit Mars.

Trashësia mesatare e arrin nga 80 derinë 1m, kurse në zonat malore 1000 m mbi nivelin e detit arrin 1.5 deri në 2.5 m.

Për një periudhë 30 vjeçare veçori janë vitet 1985 me temperaturë absolute -22gradë C me datë 19 shkurt ku lartësia e borës arriti nga 1.25 deri në 2. m.

Numri mesatar i ditëve me dëborë është 24 ditë. Më shumë zgjat në muajin Janar 10.4 ditë. Numëri mesatar i ditëve me dëborë shkon nga 40 deri në 100 ditë.

Erërat veriore e verilindore janë karakteristik e periudhës dimërore të cilat përbëjnë 23.6% të të gjitha rasteve. Shpejtësia e erës mesatare shkon 11-15 m/s.

Trashësia e mbulesës së dëborës prej 10 cm sjell një shtresë akulli me trashësi 5 mm, që është e mjaftueshme për të ndërprerë trafikun normal në zonat që prek, madje pengon operacionet e emergjencës.

Megjithatë, grumbullimi i dëborës rreth 25-50 cm e bllokun tërësisht qarkullimin e makinave të zakonshme. Në rast se nuk bëhet pastrimi rregullisht prej dëborës, trafiku mund të bëhet vetëm me automjete të posaçme.

Blokim i popullsisë –rrëziku dhe elementët e parapërgatitjes :

Mundësia e bllokimit të popullsisë nga dëbora e llogaritur si popullsi banuese brenda konturit të hapësirës që mbulohet me dëborë me lartësi të paktën 30 cm shkon deri në 51.3%, në kushte të klimës më të skajshme. Duke mbajtur parasysh rezervat e ushqimit brenda shtëpive dhe të furnizimeve të tjera si dhe stogjet e tregut në vend , një periudhë bllokimi më e gjatë se 30 ditë duhet të quhet kritike për planifikimin e përgatitjes për emergjencë.

Infrastruktura aktuale ka krijuar fenomenin e frymëmarrjes në qarkullimin e njerëzve ,mjeteve e mallrave duke influencuar drejtëpërsëdrejti në përballimin e emergjencave civile.

Kompanitë kontraktore kanë krijuar një bazë logjistike dhe një performancë të kënaqshme për ndërhyrje.

Rrëzimet nga Zjarret:

Sezoni veror në Bashkinë e Dibrës shoqërohet me temperature të larta , pasojë e së cilës është fenomeni i zjarreve. Sipas statistikave mesatarisht në vitet, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 kemi patur nga 122-150 raste zjarresh të cilat kanë përshkuar mbi 500- 800 ha me kullota, dushqe, pisha e ah, si pasojë kemi patur edhe zjarreve në një vit 20-25 banesa e në biznese private 5-10 raste me dëme të konsiderueshme ekonomike, ku në disa raste dhe në njerëz.

Sipërfaqet e djegura në zona të mbrojtura dhe në pyje të Bashkisë për periudhën 2021 -2022 është: Për vitin 2021 Zona të mbrojtura 5.9 ha dhe pyje të Bashkisë 30 ha gjithsej 35.9 ha.

Për vitin 2022 në zona të mbrojtura 1.8 ha dhe pyje të Bashkisë 68 ha gjithsej 69.8 ha.

Zjarret në pyje në pesë vitet e fondit paraqesin probleme serioz në Bashkinë Dibrë.

Sipërfaqet e djegura në pyje komunale në pyjet komunale në pesë vitet e fundit është 435 ha, dhe në zonat e mbrojtura është 47.2 ha, gjithsej 482 ha konkretisht:

Nr	Sipërfaqia e djegur në ha		Gjithsej	Viti
	Zona të Mbrojtura	Pyje Bashkiake		
1	2	24	26	2018
2	6.5	37	43.5	2019
3	31	276	307	2020
4	5.9	30	35.9	2021
5	1.8	68	6	2022
Totali	47.2	435	482.2	

Sipërfaqia totale e Bashkisë është 937.88 km², rreth 60% e sipërfaqes është pyll ose kullot.

Bashkia administron në total një fond pyjor prej 36662 ha, pyje / kullota.

Agjensia e zonave të mbrojtura administron një sipërfaqe prej 27843 ha pyje / kullota.

Problematikë për bashkinë tonë janë zjarret në pyje.

Rreth 70 % e popullsisë së bashkisë Dibrë, jetojnë në zona rurale të cilat janë të lidhura me bujqësinë, kryesisht prej veprimtarive të bujqësisë ekstensive dhe blegtorisë. Keqpërdorimi i pyjeve nga njerëzit dhe praktikat e kullotjes, pa dyshim, janë shkaktarët e pjesës më të madhe të shkatërrimit të pyjeve.

Kullotja e pakufizuar dhe zjarret e pakontrolluara, të shkaktuara aksidentalisht dhe shpesh për shkak të djegies me qëllim pastrime kullotash, vijnë të ndodhin në shkallë bashkie.

Dëmet në të korra, të shkurreve e të kullotave dhe humbjet përkatëse, që për një vit arrijnë në miliona lekë, janë humbje të drejtpërdrejta ekonomike.

Gjatë periudhës së stinës së verës sidomos në periudha të thata e me temperatura të larta, zjarret kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në masivet pyjore e kjo sidomos në vitet 2007, 2008, 2012, 2016, 2017, 2020.

Në këto vite janë dëmtuar qindra ha pyje nga ato të reja deri në dhjetra vjeçare.

Denduria e zjarreve të pyjeve ndryshon gjeografikisht, duke qenë më e lartë në rrethin e Dibrës. Shkaqet kryesore të zjarreve janë pakujdesia e njerëzve, djegia për kullota dhe rritje të hapsirave natyrore. Shumica e dëmeve ndodhin në pyjet halore.

Masat për menaxhimin e zjarreve, që janë përdorur nga strukturat përgjegjëse kanë qenë:

Vënia në punë e një sistemi vrojtimi e sinjalizimi, vigjilencë për rastet gjatë gjithë periudhës së

shtimit të rrëzikut të zjarreve dhe ndërtimi i pritave kundër zjarrit.

Duke u ballafaquar me këtë problem, kaq të mprehtë tashmë ekziston një strategji e mbrojtjes së pyjeve e cila kërkon kontributin e të gjithë strukturave për tu bërë efektive dhe për të arritur rezultatet e pritshme për mbrojtjen e kësaj pasurie kombëtare siç janë pyjet.

Deri tani reagimi e përgjegjësia nga njësitë vendore ka qënë të paktën për Bashkinë e Dibrës e pjesëshme ose në nivele të ulta.

Është koha të mendohet për një sistem unik të përgjigjes ndaj zjarreve si sistemi i vrojtimit e lajmërimit apo evakuimit të popullatës në rrëzik.

Modernizimi i strukturës operacionale si me zjarrfikëse deri në helikopter.

Rrëshqitja e tokës:

Vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga rrëshqitjet e tokës :

Bashkia e Dibrës ka si tipar paqëndrueshmëritë masive të tokës, këto lloj fenomenesh gjeodinamike janë pasojë e kombinimit të faktorëve pasiv, ku futet ndërtimi gjeologjik dhe relievi, pjerrësia e madhe e shpateve si dhe e një rrjeti hidrografik të shumtë në të cilën lëvizin ujrat me shpejtësi të madhe.

Më të rrezikshme paraqiten në situatën kur këta shkëmbinj bien në drejtim të shpatit.

Një rol negativ ka luajtur vetë njeriu nëpërmjet shpyllëzimit e formimit të tokave të reja arë.

Sipas llojit të paqëndrueshmërisë së tokës kemi këto veçori në Bashkinë e Dibrës:

Rënia e shkëmbinjëve është karakteristikë e rajoneve malore të Alpeve të Shqipërisë, e shpateve gëlqerore të zbuluara ndaj kushteve të klimës së ftohtë dhe shirave të bollshme në masivin gëlqeror të malit të Korabit.

Shembjet:

Janë karakteristikë për rajonet malore të Bashkisë. Raste të tilla janë shfaqur në njësitë Sllovë të rrethit Dibër.

Rrëshqitjet me zhvendosje:

Rrëshqitjet kryesore janë në zonën tektonike-forciale të Korabit. Fshatrat më të rrezikshme janë Sllovë, Dypjakë, Krej - Reç

Janë mbi 15 objekte banimi të cilat me kalimin e viteve do të kenë probleme të drejtëpërdrejta me këtë fenomen.

Rjedhjet janë fenomene të kufizuara që krijohen kryesisht nga reshjet e shumta.

Erozioni :

Vjen si rezultat i shpyllëzimeve dhe pjerrësitë e larta të terrenit, mosfunksionimi i ujrave sipërfaqësore.

Duhet të bëhet një rishikim i plotë në nivel lokal, rajonal në lidhje me situatën e reshjeve, planet dhe veprimet e strukturave si dhe cilësia e operacioneve të ndërmarra në fazën e përballimit.

Rrëziqet nga tërmetet:

Bashkia e Dibrës ashtu si vetë pozicioni i vendit tonë shtrihet në brezin sizmik, alpin-mesdhetar, që përfshin zonën e kontaktit ndërmjet pllakave litosferike të Afrikës e të Euroazisë, e cila shtrihet nga ishujt Azore deri në kufirin lindor të pellgut të Mesdheut.

Bashkia e Dibrës është shtrirë në zonat e ashtuquajtura “mesatare” për sa i përket intensitetit të termeteve. Shkalla e intensitetit është 6 deri në 7 ballë. Origjina e tërmeteve në bashkinë tonë është e karakterit tektonik. Faktorët që ndikojnë në intensitetin e tërmeteve është edhe fortësia e shkëmbinjve. Kemi tre lloje shkëmbinjsh me forcë të lartë mesatare e të ulët. Bashkia e Dibrës

ka shkëmbinj me forcë relativisht të lartë dhe të ulët që përfaqësohen nga mbulesat e aluvioneve dhe deluvioneve. Intensiteti i tërmeteve me veprat inxhinierike që janë ndërtuar në shkëmbinj të fortë është më i vogël se në veprat inxhinierike që janë ndërtuar mbi veprat e aluvioneve dhe deluvioneve. Bashkia e Dibrës është goditur nga tërmetet në vite 1967, 1979, 1998, 2008 e në fundtë vitit 2014, 2018, 2019, ku kryesisht ka patur dëme në objekte ndërtimi.

Vlerësimi i rrezikut nga tërmetet është realizuar për periudha përsëritje 50, 100, 200, 475 dhe 1000 vjet.

Nxitimi maksimal i pritshëm i truallit (NMT-në % të g). $g=9.81\text{cm/s}$ sipas periudhës karakteristike të përsëritjes.

Skenar i Burimi sizmik PP-50 PP-100 PP-200 PP-475 PP-1000max.

Përdorimi i hartës aktuale të zonimit sizmik është përcaktuar për projektimin e ndërtesave të zakonshme. Aktualisht për vepra të rëndësishme dhe objekte të larta është detyrim ligjor të bëhen studime të detajuara inxhiniero –sizmologjike për të nxjerrë të dhëna konkrete në lidhje me rrezikun sizmik për sheshe konkrete ndërtimi.

Nëpërmjet studimit "Vlerësimi i Rreziqeve në Shqipëri" është realizuar përherë të parë vlerësimi tërësor i elementeve të domosdoshme për nevoja planifikimi dhe menaxhimi të emergjencave shkaktuar nga tërmetet.

Rreziku i përmytjeve :

Përmytjet e shkaktuara nga lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë, shpesh prekin luginat e bashkisë të Dibrës, duke dëmtuar rrjetin rrugor dhe tokat bujqësore. Janë 1 lum ose disa përrenj që përfaqësojnë një rrezik të përhershëm për përmytje. Karakteristika kryesore e tyre është se janë shumë të shpejtë dhe shpesh të "pa besë", sjellin volume të mëdha aluvionesh dhe mund të shkaktojnë dëme të pa parashikueshme në infrastrukturë, objekte banimi dhe bujqësi.

Digat dhe rreziqet :

Ngritja e digave në bashkinë e Dibrës ka nisur pas viteve 60-70'. Digat e para u ndërtuan për qëllime bujqësore. Sot ka 22 sisteme rezervuare me diga. Lartësia e të gjitha digave varion nga 10 m deri në 37 m. Të gjitha digat e larta në bashkinë tonë janë të tipit me mbushje dheu.

Kushtet ekzistuese :

Projektimi dhe ndërtimi i digave mbështetet në një analizë të gjithanshme të të gjithë faktorëve që lidhen me të dhe që prekin sigurinë e vetë digës si dhe të sistemit digë/rezervuar. Për të siguruar kufijtë e sigurisë së projektuar gjatë gjithë periudhës së ekzistencës, rëndësi të dorës sëparë ka mirëmbajtja e sistemeve gjatë shfrytëzimit të tyre. Mirëmbajtja e rregullt dhe e frytshme duke përfshirë rehabilitimin në kohën e duhur, janë në vecanti thelbësore për sistemet digë / rezervuar ndërtuar me dhe e gurë.

Me vjetërimin e digave, siguria e punës së tyre është problem.

Kjo kërkon më shumë vëmendje në formën e inspektimeve, vlerësimeve, modifikimeve dhe përmirësimit të digave të vjetëruara, në mënyrë që të përballojnë standartet dhe rregullat e teknologjisë së kohës. Digat në bashkinë e Dibrës prekin një popullsi prej 15000 – 20000 banorësh.

Rreziqet nga aktet terroriste:

Duhet theksuar se bashkia e Dibrës nuk ka përjetuar ndonjë sulm terrorist dhe në përgjithësi nuk konsiderohet si një vend me rrezik të veçantë për sulmet terroriste. Sidoqoftë ngjarjet e sulmeve terroriste janë rritur, prandaj ky rrezik është prezent.

GRUPET E PUNËS PËR MONITORIM NDJEKJE E ZBATIM TË DETYRAVE NË PËRBALLIM TË SITUATAVE TË EMERGJENCËS CIVILE

Nga administrata e Kryetarit Bashkisë do të krijohen grupet e punës:

Grupi Informacionit

Donald Ademi
Florian Tomçini
Hazbi Kamberi

Kordinator
Drejtore Informacionit
Drejtori PPECK

Përgjegjës

Grupi i vlersimit:

Ervis Manga
Përgjegjës Edvin Shahi
Elona Lusha

Drejtor Zhvillimit Urban
Sekt. Zhvillimit Urban
Përgj. Sek. Juridik

Grupi i ndjekjes dhe shpërndarjes së ndihmave:

Donald Ademi

Kordinator

Përgjegjës

Habedin Paci

Dr. Sektorit Ndihmës Ekonomike

Xhosilda Elezi

Specialiste Finance

Në bashki kryetar komisioni do të jetë kryetari i bashkisë.
Komisioni EC do të mbledhet çdo ditë në ora 08.00 dhe 14.00.

c. Masat për paralajmërim:

Fenomenet që mund të shkaktojnë emergjenca në bashkinë e Dibrës janë rreshjet e mëdha të dëborës, temperaturat e ulëta, suferinat.

Vëzhgimi do të bëhet nga Kryetarë të fshatrave e personeli i gadishmërisë së institucioneve.

Paralajmërimi i hershëm bëhet nga shërbimi sinoptik i vendosur në Peshkopi.

Nga qendra sinoptike do të bëhet njoftimi i kryetarit e zv. kryetarit të Komisionit të Emergjencës Civile.

VI. Komunikimet:

Mënyra e komunikimit midis niveleve të ndryshme do të bëhet me telefon kabllor mobil.

Do të shfrytëzohet ndërlidhja me radio nga Komisariatet.

Gjithashtu do të shfrytëzohet ndërlidhja me strukturën e MZSH-së.

Komunikimi me mediat do të bëhet me komunikatat e shtypit të zëdhënësit të komisionit si dhe të konferencës të shtypit të organizuar nga kryetari.

VII. EVAKUIMI DHE SHPËTIMI.

Në rastet e krijimit të fatkeqësive nga orteqet apo rrëshqitjet e tokësive cila shoqërohet me pasoja në njerëz do të vepohet nga kjo strukturë operationale.

Drejtues operacioni :

Shefi i MZSH-së

MZSH-ja.
Policia e Shtetit
Policia Pyjore
Shërbimi i Ambulancës
Kryqi i Kuq

VIII. EMERGJENCA SHËNDETËSORE

Drejtoria e Shëndetit Publik do të përballojë nëpërmjet infrastrukturës së këtij shërbimi në Bashkinë e Dibrës 17 Q.SH,
Po në funksion të kësaj veprimtarie do të jenë 9 ambulanca nga të cilat 9 në Dibër.
Do të veprojnë repartet e Urgjencës Dibër,
Ndërhyrjet kirurgjikale do të bëhen në repartet kirurgjikale të spitalit Dibër.

IX. PUNIMET URGJENTE PËR RIPARIMIN E MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS RRUGORE PUBLIKE.

Ndërhyrjet më emergjente që duhet të bëhen në infrastrukturën rrugore janë:
Sistemimi e rehabilitimi i rrugëve nacionale:
Rruga e Rinisë, nga Muhurr-Reç.

Rrugët rurale:
Arras- Lurë, Muhurr-Selishtë
Muhurr – Reç

X. VLERËSIMI :

Komisioni i vlerësimit në shkallë Bashkie do të jetë:

Ervis Manga	DR. Sek.Zhvillimit Urban
Edvin SHAHI	Përgjegjës Sekt. Zhvillimit Urban
Elona Lusha	Përgj.Sek.Juridik
Xhosilda Elezi	Specialiste Finance

Nga organet vendore krijohen komisionet e vlerësimit në shkallë Bashkie / Njësi Administrative.

XI.DËRGIMI DHE SHPËRNDARJA E NDIHMAVE:

Magazinimi:

Magazinimi i mallrave do të bëhet kryesisht në qendrën e qytetit Peshkopi.
Nga biznesi privat mbahen në magazinat e tyre.
Artikuj ushqimorë e jo ushqimorë do të grumbullohen në të njëjtat magazina.

Shpërndarja:

Shpërndarja e artikujve ushqimorë e joushqimorë do të bëhet nën drejtimin e grupeve të shpërndarjes së ndihmave.
Shpërndarja do të bëhet nga Bashkia.
Nga Bashkia do të bëhet shpërndarja e drejtpërdrejtë në Nj.Adm.e kjo e fundit nëpër fshatrat nëpërmjet kryetarëve të fshatrave.

Vëzhgimi:

Do të bëhet nga anëtarët e Komisionit EC të Bashkisë.
Për çdo dërgesë do të ketë përfaqësues të bashkisë.

Raportimi:

Raportimi do të bëhet nga administratorët e Njësive Administrative e kryetari bashkisë. Për problemet e dala njoftohet menjëherë Kryetari i Komisionit EC të Bashkisë.

XII. VENDET E PËRKOHSHME PËR STREHIM :

Për strehim do të përdoren godinat e ish reparteve ushtarake.
Hoteleritë në qytete apo edhe godinat në disa shkolla në fshatra.
Shtëpitë e braktisura si rezultat i lëvizjes së popullsisë në drejtim të qendrave urbane.

XIII. SHËNDETI PUBLIK:

Do të jetë në vëmendjen e të gjithë këtyre institucioneve që lidhen me këto shërbime. Ushqimet do të mbahen nën kontrollin e vazhdueshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
Uji i pijshëm do të jetë nën mbykqyrje të vazhdueshme të epidemiologëve dhe punonjësve të tjerë të ujësjellësave.
Higjena publike do të ndiqet nga Drejtoria e Shëndetit Publik, duke ndjekur gjatë gjithë kohës gjendjen e shëndetit të popullatës.

XIV. RUAJTJA E RENDIT PUBLIK E QETËSISË PUBLIKE.

Nga Komisariati Vendori Policisë në Bashki në zbatim të Ligjit "Për Policinë e Shtetit" me Plane Veprimi do të mbajnë rendin e qetësinë publike.
Gjatë gjithë kohës do të bashkëveprohet me Kryetarin e Komisionit të Mbrojtjes Civile të bashkisë, për problemet e dala dhe masat që do të merren për eliminimin e tyre.

Automjete të Policisë do të shërbejnë për t'u ardhur në ndihme popullatës në nevojë.
Punonjës Policie për menaxhimin dhe përballimin e këtyre situatave janë gjithsej 20. Në qytet do të veprojnë forcat e specializuara e të gadishmërisë.
Në njësitë administrative inspektorët e zonave dhe policia bashkiake.
Në rastet e fatkeqësive nga Komisariati Vendori i Policisë do të bëhet izolimi i zonës e marrjes pjesë drejtëpërsëdrejti në operacionet e shpëtimit.
Policia Vendore e Kufirit dhe Migracionit ka në dispozicion mjete dhe punonjës policie.

XV. NEVOJAT PËR BAZË MATERIALE, KOSTOJA DHE PREVENTIVI.

Për përballimin e Emergjencave Civile Dimërore në bashkinë e Dibrës janë këto nevoja:
Nevojat për furnizim me mallra ushqimore të popullatës së bashkisë për periudhën 1 mujore janë:

Rrethi i Dibrës 1130 ton.

Për organet vendore është i domosdoshëm e disponibël fondi financiar në Zërin e Emergjencave Civile në masën 4%.

Për vetë kushtet e vështira malore për shërbimin shëndetësor nevojiten 3 autoambulanca 4x4.
Për ujësjellësat nevojitet një fond prej 12 milion lekë.
Në rezevat e shtetit është e domosdoshme krijimi i mallrave stoqe për ndihmë të menjëherëshme.

Elementët e ekspozuar :

Përdorimi i indikatorëve sasiorë.

SISTEMI I ALARMIT

Sistemi Shqiptar i paralajmërimit të hershëm.

- Igjeum
- Shërbimi metrologjik ushtarak- MM
- Mjetet, pajisjet, procedurat dhe instrumentet.
- Përshkrimi i buletinit dhe i kodeve të ngjyrave

Aktivitetet monitoruese në kohë reale.

Procedurat e monitorimit.


Monitorimi i të dhënave.

MODELI I NDËRHJRJES

Organizimi brenda Bashkisë.

Qendrat Kordinuese

- Komisionet kombëtare, të Prefekturës dhe të Bashkive .



Kriteret e identifikimit të Qendrave të Koordinimit /Komisionit (Nr.Referencës në shtetë pranishëm)

- Aktivizimi dhe përbërja e Komisionit të PPECF

Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive në Nivel Bashkie.

Në bazë të ligjit Nr. 45, dt. 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, me Urdhër Nr. 280 datë 25. 05. 2022 të Kryetarit të Bashkisë është krijuar dhe funksionon *Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Nivel Bashkie*, i cili ka në përbërje:

- Rahim Spahiu	Kryetari Bashkisë	Kryetar
- Lorenc Cibaku	Nënkryetar Bashkie	Zv. Kryetar
- Sajmir Kojnozi	Nënkryetar Bashkie	Anëtar
- Hazbi Kamberi	Drejtori PPECK	Anëtar
- Altin Lila	Shefi Kom. Dibër	“
- Fatos Gjoka	Drejtori MZSH	“
- Bedri Kamberi	Drejtor i Shërbimeve Publike“	“
- Çeljeta Zuna	Drejtori Ekonomik	“
- Ervis Manga	Drejtori Urbanistikës	“
- Agron Cara	Drejtori Bujqësisë	“
- Bajram Kalia	Drejtori Doganës Bllatë	“
- Lediana Gjoka	Zyra Vendore Arsimore	“
- Ruzhdi Deda	Drejtor i Spitalit Peshkopi	“

- Hajredin Cena	Përgj.Sektorit Ujsjellës Dibër	“
- Majlinda Hoxha	Ëord Vision	“
-Anisa Xhika	Drejtori Shëndetit Publik	“
-Avdi Hoxha	P.Sekt.Sektorit OSHE Dibër	“
-Kimete Mazari	Kryqi Kuq Dibër	“
-Rafaela Kaloshi	Drejtorja ISKSH	“
-Endri Deda	Përgjegjësi Policisë Bashkiake	“
-Ramazan Tema	Sekretari Komisionit MC	“
-Donald Ademi	Administrator i Nj.Administrative	“
-Administratorët sipas njësive	“	

Detyrat dhe mënyrat e funksionimit të Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel

Bashkie janë:

- Komisioni i mbrojtjes civile planifikon, koordinon dhe kontrollon të gjitha masat parandaluese, lehtësuese, dhe rehabilituese për përballimin emergjencave civile në bashki.
- Komisioni jep informacion pranë Qendrës Kombëtare të Emergjencave Civile në situatë emergjente dhe ngarkon sekretarin për të dërguar informacion në periudhë normale.
- Komisioni bën përpunimin e të gjithë të dhënave për resurset që ka në territor, bazën materialo – teknike nën administrimin shtetëror e privat dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre në situatë emergjente .
- Komisioni përgatit dhe përpunon programe trajnimi, skenare për emergjencat civile për komunitetin.
- Komisioni mbështet drejtuesit e operacionit në nivel bashkie për menaxhimin e emergjencave civile.
- Komisioni bashkërendon veprimtari në organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në raste emergjence.
- Në rast krizash, Komisioni i MC bashkëpunon me Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe koordinon veprimet me të gjitha institucionet shtetërore qendrore në nivel rajonal, organet e qeverisjes vendore, subjektet private dhe OJQ për normalizimin e situatës. Krizat mund të jenë të llojeve të ndryshme si:
Për pritjen e refugjatëve, krizë e shkaktuar nga tërmete, përmytje, nga lufta etj. Në rast se kriza është e pritshme, atëherë është më e lehtë për t'i paraprirë situatës, duke ngritur kampet me të gjitha kushtet hidro-sanitare dhe duke siguruar furnizimin me ushqime, ujë të pijshëm, veshmbathje, ngritjen e Qendrave Shëndetësore etj.
- Komisioni bashkëpunon me Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe me institucione të tjera për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera, si dhe në riaftësimin e zonave të dëmtuara.

Funksionimi komisionit :

Komisioni funksionon në situata normale dhe situatë emergjente.

Komisioni mbledhet një herë në tre muaj për situata normale dhe çdo ditë në situatë emergjente. Komisioni në mbledhjen e parë përcakton veprimtarinë e punës së tij dhe harton rregulloren e funksionimit të komisionit.

Sekretari i komisionit mban përgjegjësi për përgatitjen e materialeve dhe aktiviteteve të komisionit.

Për zbatimin e këtij urdhëri përgjigjet sekretari i komisionit.

- Hartëzimi i Qendrave Koordinuese / Komisionit :

Zonat e emergjencës

- Kriteret Kombëtare të identifikimit të zonave të Emergjencës
- Hartëzimi i zonave të Emergjencës: Dibër
 - Mjetet e Brendëshme dhe të Jashtme
- Llogjistika


Kapacitetet e Bashkisë Dibër për Menaxhimin Emergjencave Civile dhe Fatkeqësive.

Gjendja e burimeve njerëzore dhe logjistike aktuale në Bashki, në sektorin publik dhe privat që mund të angazhohen në raste emergjence për sezonin vjeshtë-dimër Bashkia Dibër.

QARKU DIBËR	Burime njerëzore dhe logjistike												
	Personeli	Ekskavatore	Fadroma	Vinca	Makinagjermidhetr ansporti të llojeve	Mjete zjarrëfikëse	Borë pastruese	Varka/skafë	Pompa thithëse uji	Autoambulanca	Laborator për kryerje analizash të ujërave, konvikte	për evakuim (sipër m2)	Numri i shtrëtvërve për evakuim, spitale, Mjete vëtskarkuese
Shërbimi Spitalor	80									8	2	294	150
Elektriku	40				2								
Ujësjiellësi	54		1		3				1				
Rrugët Nacionale	3												
Sub.Priv për Rrugët	15		3		2		3						
MZSH	21					2							
Organet vendore	121	1	4	1	7	2	3		1			150	50
Dr. Policisë Qarkut	40												

Skema e lajmërimit të drejtuesve të Qeverisjes Vendore Bashki Dibër

Skema e sistemit të lajmërimit, Nr.tel si pika kontakti të shërbimit të gadishmërisë 24 orëshe.



Skema e sistemit të lajmërimit, nr tel dhe të dhënat të tjera të anëtarëve të Komisionit të

Emergjencës Civil në nivelin e Bashkisë.



Përshkrimi i modelit të ndërhyrjes.

Mënyra e aktivizimit të Qendrës së Koordinimit / ose Komisionit në parashikim dhe në përgjigje.

Aktivizimi i funksioneve operacionale

Srukturat monitoruese :

Sruktura monitoruese në bashki janë: Salla Operative e Policisë së Shtetit, Shërbimi Zjarrfikës, Srukturate EC në bashki nëpunësit me funksion të dytë për EC në administratën e njësisë vendore, stacioni

hidrometeorologjik, sizmik.

Srukturat vepruese aktive :

Strukturat kryesore aktive ose forcat operacionale janë:

Forcat Vepruese Aktive (Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Dibër, SHMZSH, Shërbimi Ambulator, Shërbimi Spitalor të cilat kryejnë funksionet e tyre në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile. Këto strukturat janë forca të shërbimit të mbrojtjes civile në varësi të bashkisë. Gjithashtu pjesë e strukturave të EC vepruese është edhe vetë komuniteti.

Strukturat mbështetëse :

Struktura mbështetëse në bashki janë:

Inspektoriat Shtetëror i Pyjeve, Mjedisit dhe Ujrave, Drejtoria Rajonale e Bordit të Kullimit Durrës OSHEE, OST, Nj. T. L, Sektori i Ekstensionit Bujqësor, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Zyra Vendore të Arsimit, Rajoni Qendror për Rrugët Nacionale Shkodër, Drejtoria Rajonale e Rezevave Materiale të Shtetit, Agjensia Rajonale e Mjedisit, Grupet vullnetare, KKSH, Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, OJF-të.

Etapat për aktivizimin e SSHECQ :

Nëpërmjet etapave të aktivizimit të sistemit sigurohet përdorimi i kapaciteteve në mënyrë të përshtatshme për të gjitha llojet e emergjencave edhe pse, sipas situatave mundë të mos kalohet në të gjitha etapat. Në rastin e një ngjarje të papritur, të menjëherëshme, aktivizimi i sistemit fillon menjëherë direkt me etapën

3“aktivizimi”. Në çdo rast, në se merret informacion paralajmërues, për të siguruar parapërgatitjen optimale, shfrytëzimin në maksimum të burimeve dhe bashkërendimin në mënyrën më të mirë të mundshme dhe të përgjigjes në shkallë rajonale dhe kombëtare ndaj emergjencës, ndiqen katër etapat e mëposhtme:

Etapat I: “Alarm për rritjen e gatishmërisë” kryetari bashkisë në çastin e marrjes së njoftimit paraprak ose informacionit të mundësisë së ndodhjes të një ngjarje (e cila mund të shoqërohet me dëmtime nënjerëz dhe dëme materiale.)

Nr	Prefekti i Qarkut : ETAPA 1. "ALARM PËR RRITJEN E GADISHMËRISË"	Kontrolli relizimit të aktivitetit
1	Në Bashki ngrihet Zyra e Informacionit dhe Menaxhimit të EC në territorin Bashkisë përkatëse.	
2	Informon Ministrinë e Mbrojtjes, Prefektin për kalimin në gjendje "Alarmi për rritjen e gadishmërisë".	
3	Komunikon me zyrat e EC-së dhe drejtuesit e organeve të pushtetit vendor	
4	Informon të gjithë institucionet dhe strukturat e duhura.	
5	Informon institutet shkencore dhe kërkon prej tyre dhënien e informacionit të vazhdueshëm dhe parashikimin për zhvillimin e situatës.	
6	Jep urdhërin për funksionimin e QOQ, verifikimin e stafit të mjaftueshëm dhe të paisur për punë 24 orë gjatë etapës "Alarm për rritjen e gadishmërisë".	
7	Në QOQ-në, kontrollon mjetet e komunikimit, numrat e telefonave celulare, radion, llambat e ndriçimit dhe siguron që telefonat të jenë të ngarkuar. Vendos në dispozicion numrat shtesë telefonik të institucionit dhe njoftohet personeli (operatorë të komunikimit) për situatën.	
8	Verifikon që mjetet e transportit të institucionit të jenë në gadishmëri të pajisura me mjete të nevojshme, karburant dhe kanë rezerve karburanti. Për plotësimin e nevojave nxjerr urdhër për venien në dispozicion të 1-2 mjeteve të institucioneve të tjera.	
9	Kërkon DRSH-të Mat konfirmimin e nivelit të stokut, gjendjen dhe vendndodhjen.	
10	Siguron informacion të saktë për të bërë paralajmërimet dhe këshillimet e duhura për publikun me anë të mjeteve të informimit. Për këtë cakton zëdhënësin për komunikimin me shtypin dhe jep udhëzime për këtë qëllim.	
11	Përgatit informacion të përmbledhur për MM, Qeverinë dhe degën e Kryqit të Kuq.	

Etapa II : Vendosja e Gjendjes së Gadishmërisë :

Bëhet kur një ngjarje e afërt konsiderohet e pashmangshme dhe që mund të shoqërohet me dëme në njerëz dhe materiale.

Kryetari bashkisë: ETAPA 2: VENDOSJA E GJENDJES SË GADISHMERISË	Kontrolli realizimit te aktivitetit
1. Informon Prefektin dhe Ministrin e MM rreth situatës dhe nevojës për fillimin e etapës 2 "Vendosja e Gjendjes së Gadishmërisë" i cili vendos për fillimin e kësaj etape.	
2. Mbledh Komisionin e Emergjencave Civile dhe grupin e specialistëve si dhe kërkon përgatitjen për procesin e marrjes së vendimeve, takimeve informative për median dhe partnerët.	

3.Komunikon (Zyra e EC dhe QOQ) me drejtuesit vendor (Punonjësin e Emergjencave Civile), duke kërkuar mbledhjen e KVEC-së dhe ndjekjen e situatës sipas planeve të emergjencës.	
4.Informon të gjithë institucionet dhe strukturat e duhura, veçanërisht ato që përfshihen në përgjigjen e parë (njoftimi paraprak / informimi i publikut, evakuimi, kërkim-shpëtimi,ndihma e parë, zjarrfikësit dhe sigurimi i vendeve të strehimit të përkohshëm).	
5. Komunikon me institucionet, strukturat monitoruese dhe kërkon prej tyre dhënien e informacionit të vazhdueshëm për parashikimin e situatës, informacion i cili dërgohet në mënyrë të menjëherëshme Prefektit dhe Ministrit të Mbrojtjes.	
6.QOQECsiguron dërgimin urgjent të të gjithë të dhënave edhe parashikimeve të ardhura nga QKOE Punonjësve të Emergjencave Civile dhe anasjelltas në QKOE.	
7. Zyra e EC-së (QOQEC) harton Raportin e Parë të Situatës dhe informacioneve të rezervuara për Prefektin i cili sipas rastit i dërgohet Ministrit të Mbrojtjes ose Kryeministrit.Përmbledhja e raportit që vjen nga lart mundë të qarkullohet si informacion i rezervuar tek disa drejtues, sipas vlerësimit të Prefektit.	
8.Kontrollon dhe siguron që të gjithë masat e mëparshme janë përmbushur.QOQEC-ja punon me staf të plotë, të pajisur për të punuar në Etapën e Gatishmerisë për 24 orë.	
9. Krijon një Grup të Përbashkët Vlerësimi për në zonat e prekura nga fatkeqësia,verifikimin e të dhënave për situatën dhe në mbështetje të strukturave të emergjencave civile.	
10.(Zyra e EC dhe QOQEC) përgatit materiale paraprake mbi dëmet,nevojat e pritëshme dhe forcat operationale që mundë të përfshihen për përballimin e emergjencave, nisur nga informacionet, për zonën, natyrën e fatkeqësisë, vlerësimi i rreziqeve, etj.	
11.Përgatit (zëdhënësi) informacione për publikun,median dhe raporte periodike për instancat qeveritare, donatorët, KKSH dhe OJF-të e interesuara.	

Etapa III:Aktivizimi fillon në rastet kur një ngjarje e papritur ka shkaktuar dëmtime në njerëz dhe materiale, ose kur një ngjarje e ngadaltë është në zhvillim e sipër dhe mundë të sjellë të njëjtat pasoja të cilat tejkalojnë mundësitë për t'u përballuar nga strukturat e SHEC-së.

Ministri i Mbrojtjes është autoriteti që njofton fillimin e etapës 3 “aktivizimi”, duke angazhuar struktura të përherëshme që në misionin e tyre kanë detyra për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile.Në rast se emergjenca është e përmasave të mëdha dhe është shpallur gjendja e emergjencave civile nëmbledhjen e parë të KPPEC, prefekti emëron drejtuesin e operacionit në nivel qarku i cili do të marrë drejtimin përgjigjen në nivel qarku dhe ndihmën kombëtare, nëse është e nevojshme.

ETAPA 3. AKTIVIZIMI	Kontrolli
Për emergjenca të shkallës së ulët : kryetari bashkisë :	përfundimit aktivitetit
1. Sigurohet për aktivizimin e strukturave dhe kapaciteteve të përgjigjes në nivel bashkie dukepërfshirë dhe venien në funksion të KVEC-vetë njërive vendore dhe informon Prefektin dhe Ministrinë e Mbrojtjes.	
2. (Zyra EC,QOQEC) kërkon informacion nga drejtuesit e bashkive / njësive administrative.	
3.Qendron në kontakt me institucionet qendrore dhe donatorët brenda vendit,përsigurimin e mundësive të mbështetjes.	
4.Kërkon aktivizimin e menjëhershëm të gjithë institucioneve dhe strukturave operacionale.	
5.Nëse është e nevojshme,i kërkon Prefektit, Ministrit të Mbrojtjes ose Kryeministrit të deklarojë gjendjen e Emergences Civile për zonën e përfshirë.	
6. Nëse nuk është bërë ende, krijon Grupe të Përbashkëta Vlerësimi për t'u dërguar në zonat e prekura nga fakeqësia,për verifikimin e të dhënave të situatës dhe mbështetjen e autoriteteve vendore.	
7.Kerkon (Zyra e EC,QOQ) informacion periodik rreth situatës në terren,nga Grupet e Përbashkëta të Vlerësimit dhe KVEC-të e njësive vendore dhe informon QKOEK, AKMC.	
8. Komunikon me institucionet, strukturat monitoruese dhe kërkon prej tyre dhënien e informacionit të vazhdueshëm për parashikimin e situatës, informacion i cili i dërgohet nëmenyrë të menjëherëshme Ministrit të Mbrojtjes.	
9. Dërgon menjëherë të gjitha të dhënat dhe parashikimet për SEC në nivele të ndryshme.	
10. Siguron që QOQ-ja të punojë me staf të plotë dhe të paisur për punë 24 orë.	
11.Përgatit(zëdhënësi)informacione për publikun,median dhe raporte periodike për instancat qeveritare, donatorët, KKSH dhe OJF-të e interesuara.	
Për fatkeqësi të shkallës së lartë: Pas emërimit, DOQ do të sigurojë keto aktivitete	
12. Verifikon që hapat e sipërshtuara 2-12, janë përmbushur.	

13.Në varësi nga nevoja ti propozon KPPECQ,DQO-së kërkesë për ndihmë nga qendra si p.sh: grupe kërkim-shpëtimi, logjistike, spitale fushore, mjete transporti speciale, etj.	
14.Nëpërmjet QOQ-së drejton operacionet e strukturave dhe atyre të ardhura në ndihmë në mbështetje të drejtuesve të operacioneve në bashki / njësi.	
15.Përgatit raporte për situatën,kërkesa për ndihmë,komunikon me median e publikun dhe inspekton direkt operacionet në terren.	

Etapa IV: “Dalja nga situata” bëhet nga i njëjti autoritet që ka njoftuar fillimin e etapës 1, 2 ose 3.

Në etapën 4 “dalja nga situata” mund të kalohet menjëherë pas etapës 1 ose etapës 2 dhe pa kaluar situatën e fatkeqësisë ose nga etapa 3 kur një ngjarje ka ndodhur realisht. Etapa 4, “dalja nga situata”paraqet situatën normale, kur nuk ekziston kërcënim i drejtpërdrejtë. Në çdo rast dalja nga situata bëhet kur:

- Është bërë vlerësimi i plotë i situatës.
- Kërcënimi i fatkeqësisë është zvogëluar.
- Operacionet e ndihmës kanë dhënë rezultatet e duhura.
- Nevojat me imediate janë plotësuar.

ETAPA 4. DALJA NGA SITUATA	Kontrolli i përfundimtit të aktivitetit
Kryetari Bashkisë ndjek etapën 4 “Daljen nga Situata”	
1.Pasmarrjes së njoftimit për“daljen nga situata”,komunikon me drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore.	
2.Verifikon nëpërmjet zëdhënësit që informacioni dhe këshillat e duhura u janë transmetuar publikut nëpërmjet mjeteve të informimit publik.	
3.Informon të gjitha institucionet / struktura monitoruese rreth gjendjes“daljanga situata”.	
4.Informon të gjithë institucionet dhe strukturat e duhura të listuara në rreth gjendjes “dalja nga situatë”.	
5.Harton(zyra e EC) Raporte Përfundimtare të Situatës dhe i shpërndan në të gjithë institucionet përkatëse vendore.	
6.Përgatit (zëdhënësi) informacion për mbledhës,për njoftimin e Etapës“dalja nga situata”, për median, donatorë, KKSH dhe përfaqësuesit e OJF-ve.	
7.Mbledh (zyra e EC,QOQ) të gjitha të dhënat,raportet,hartat dhe korespondencën duke i vendosur ato në dosjet përkatëse në datë / numrin dhe titullin përkatës.	
8. Mbyll QOQEC duke kaluar personelin në gjendje normale të punës.	

9. Kthen linjat e telefonave, automjetet e vëna në dispozicion çdo paisje të marrë hua.	
10. Kontrollon që mjetet e transportit të institucionit janë kthyer në vendin e parkimit, kutitë e paisjeve të punës janë plotësuar me materialet shtesë dhe nëse është e nevojshme janë bërë shërbimet shtesë të riparimit dhe furnizimit me karburant.	
11. Kërkon gjendjen e shpenzimeve financiare dhe mbledhjen e faturave përkatëse.	

12. Kontrollon mjete të komunikimit, rishikimin e numrave të telefonave celularë, nëse është e nevojshme pajisjet e ndricimit, etj.
13. Merr informacion nga drejtoria e R.SH. Mat për gjendjen e rezervës dhe plotësimin e saj.

Kontrolli i listës së shërbimeve thelbësore

Organizimi i Qendrës / Komisionit të Koordinimit

● Grafiku i Organizimit

● Funksionet operacionale

● Përshkrimi i Funksioneve Mbështetëse në “kohë normale” dhe në “kohë emergjence” – aktivitetet

● Zinxhiri i Komandës dhe i Kontrollit

● Lidhja ndërmjet niveleve të sipërme dhe të poshtme

Fluksi i komunikimit :

Përshkrimi i mjeteve dhe i pajisjeve të përdorimit në situatë emergjente.

Dallimi ndërmjet situatës normale dhe situatës emergjente.

6 FAZAT OPERACIONALE

. Përshkrimi i Fazave e lidhja me nivelet e alarmit.

. Alarmi, Në Pritje, Aktivizimi, dalja nga gjendja e Alarmit.

. Përshkrimi i niveleve të alarmit dhe përshkrimi i veprimeve në fazën operacionale.

7 INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI ME POPULLSINË.

Informacioni dhe komunikimi.

- Mjetet ekzistuese të informacionit. Shpjegimi i komunikimit të informacionit me popullsinë nëpërmjet kanaleve zyrtare, mediave etj.

- Kur nuk është shpallur gjendje e Emergjencës Civile, komunikimi me publikun bëhet nga MM.

- Kur është shpallur gjendje e Emergjencës Civile, komunikimi me publikun bëhet i përqëndruar nga zyra e Kryeministrit.

Rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazës së përgjigjes.

Menjeherë pas informimit rreth emergjencave, ose ngjarjeve të mundëshme të cilat mund të shkaktojnë një emergjencë në nivel lokal, punonjësit e emergjencave civile ose autoritetet e zgjedhura në nivel vendor do të ndërmarrin veprime të njëjta në mbështetje dhe plotësim të S.SH.K.E.C-së

Organet e Qeverisjes Vendore	Kontrolli i përfundimit të aktivitetit
1. Jep informacion për Prefektin, QOQ-në ose direkt në QKOEK rreth ngjarjeve të mundëshme të rrezikut. (Etapa 1 Alarmi)	
2. Mbledh KVEC-në në nivel bashkie (Etapa 2 Gatishmëria)	
3. Harton raporte të situatës me shkrim për Prefektin QOQ ose direkt për QKOEK. (Etapa 2 Gadishmëria dhe Etapa 3 Aktivizimi).	
4. Ndjek detyrat, funksione dhe përgjegjësitë e veçanta të planifikuara për organete qeverisjes vendore. (etapa 3 Aktivizimi)	

Gjatë fazës së përgjigjes, që mund të quhet me vendimtarje, Rolet dhe Përgjegjësitë për çdo aktivitet janë si më poshtë:

Aktivizimi dhe Bashkërendimi i Forcave Operacionale në nivel vendor.

Aktivizimi i FO në nivel vendor bëhet nga drejtuesit e organeve të pushtetit vendor, ndërsa aktivizimi dhe bashkërendimi i strukturave të DVPSH, SHMZSH, në nivel qarku dhe i strukturave që vijnë në ndihmë janë përgjegjësi e Prefektit i cili këshillohet nga KPPECQ.

Aktivizimi dhe Bashkërendimi i Strukturave Vepruese Aktive dhe Mbështetëse.

Në rast se nuk janë mobilizuar ende, Drejtuesi i Operacionit u kërkon institucioneve përkatëse, aktivizimin e strukturave vepruese aktive (SVA) dhe mbështetëse. Bashkërendimi i aktiviteteve të DVPSH, SH/MZSH, është përgjegjësi e QOQ i cili mbështetet nga KPPECQ (Zyra e EC).

Operacionet e Kërkim-Shpëtimit (SAR)

Grupet kombëtare të Kërkim-Shpëtimit sigurohen nga: Ministria e Mbrojtjes (MM), Ministria e Brendshme (MB), MZSH, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës (MIE), grupe vullnetarësh:

Operacionet e Kërkim-Shpëtimit në qark mbështeten nga grupet kombëtare të Kërkim-Shpëtimit.

Vlerësimi i nevojave: Emergjencat e Shkallës së Ulët

Bashkërendimi për vlerësimin e nevojave për ngjarje apo emergjencat të shkallës së ulët, është nën përgjegjësinë e Prefektit të Qarkut të prekur nga emergjencat si dhe nga drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore të cilët mund të mbështeten nga DPPEC, dega e KKSH ose grupe të përbashkëta.

Vlerësimi i Nevojave: Emergjencat të Shkallës së Lartë

Bashkërendimi dhe Vlerësimi i Nevojave është nën përgjegjësinë e KNEC-së, nëpërmjet Grupit të Përbashkët të Vlerësimit. Grupi i Përbashkët i Vlerësimit i KNEC-së mbështetet drejtpërsëdrejti nga DPPEC dhe grup specialistësh të organeve qendrore nga personeli tjetër shtesë duke përfshirë Prefektin, punonjësit e Emergjencave Civile, punonjësit e Njësive Administrative dhe Bashkive dhe personelin e KKSH në Zyrat Qendrore dhe degët saj.

Vlerësimi i dëmeve (në aspektin e dëmtimeve të infrastrukturës dhe objekteve të ndërtimit)

Vlerësimi i dëmeve në infrastrukturë dhe objektet e banimit për emergjencat e shkallës së ulët, bëhet nga administrata e Prefektit e mbështetur nga DPPEC dhe për emergjencat e shkallës së lartë nga Grupet Përbashkëta të Vlerësimit.

Mbështetja teknike kryesore sigurohet nga specialistët dhe institucione me të specializuara në lidhje me dëmet duke përfshirë : Entin Kombëtar të Banesave (EKB), Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Fakultetin Inxhinierisë së Ndërtimit, Drejtoritë e Mirëmbajtjeve të Rrugëve, Institutin e Sizmologjisë (IS), Institutin e Studimit të Rrugëve, Institutin e Studimit të Tokave, specialistët e institucioneve private, etj.

Është roli dhe përgjegjësia e të gjithë institucioneve, strukturave, autoriteteve lokale përkatëse dhe subjekteve të sektorit privat dhe (kur është e nevojshme) edhe e publikut të gjerë, të sigurojë informacion të vazhdueshëm nga terreni për QKOE-në dhe QOQ-në. Kjo i mundëson AKMC, Prefektin (KPPEC) për të bërë propozime të drejta për MM dhe KKECK. Kjo përgjegjësi përfshin sigurimin e informacionit teknik dhe shkencor në lidhje me kushtet dhe situatën hidrologjike, sismike, meteorologjike dhe të mjedisit. Informacioni vjen në QKOE-në, të (nga) Prefekti, (KPPEC), nga DOQ, KVEC në nivel Njësie Administrative dhe Bashkie dhe drejtuesit e tyre të Operacioneve dhe nëse është formuar, Grupi i Përbashkët i Vlerësimit të dëmeve dhe nevojave.

Njoftimi i hershëm, ai i parë, informimi dhe këshillimi i publikut.

Përgjegjësia kryesore për informimin e popullsisë në nivel vendor, në varësi të shpejtësisë dhe shkallës së emergjencës, është e drejtuesve të organeve të pushtetit vendor; Njësia Administrative dhe Bashkisë, Prefektit (zyrë e EC) dhe SEC, si dhe e Forcave Operacionale në terren. Njoftimi, informimi dhe këshillimi i publikut sigurohet nga Radio-Televizioni Publik Shqiptar, Media Private në qark (elektronike, kombëtare dhe e shkruar), sistemi shkollor, vullnetarët e KKSH, organizatat e Shoqërisë Civile si dhe mjete e burime të tjera.

Kërkesat për transport në kohë emergjence dhe kapacitetet e disponuara bashkërendohen në nivel kombëtar nga DQO. Prefekti (KPPEC dhe Zyra e EC) kërkon për sigurimin e mjeteve të transportit, qofshin këto në varësi të institucioneve qendrore dhe të sektori tprivat etj. Në nivel vendor, punonjësit e emergjencave civile mbajnë inventare të kapaciteteve të disponuara duke përfshirë edhe ato të sektorit privat.

Hyrja për në zonat e prekura nga emergjencat.

Situatat Emergjente sigurohen nga DQO-ja dhe strukturat përgjegjëse për emergjencat civile në nivel vendor. Hap dhe pastrimi i rrugëve nacionale, urave është përgjegjësi e Njërive të Qeverisjes Vendore. Për realizimin e saj mundë të kërkohe mbështetje nga kapacitetet e DPRR, të Bashkive në varësi të Këshillit të Qarkut, nga MM,MRP(Ministria e Rindërtimit P), MRRTT (Ministria e Rregullimit të Teritorite Turizmit) dhe të kontraktuar nga sektori privat, të cilët disponojnë paisje për këtë qëllim.

Në rastet kur në zonat e prekura nga emergjenca ka rrugë rurale,urbane të bllokuara,përgjegjësinë për çbllokimi e tyre e kanë autoritetet që i kanë në inventarin e tyre dhe në rastë nevojë mbështeten nga strukturat si në rastin rrugëve nacionale. Në të dy rastet, kur ato nuk mundë ta përballojnë me kapacitetet e tyre teknike çbllokimin rrugëve, atëherë i drejtohen për ndihmë Prefektit (DOQ,KPPECQ)dhe ky i fundit DQO, MM, (QKOEC-së).

Kontrolli i kufijve në kohë emergjence.

Përgjegjësia për kontrollin dhe zbatimin e rregullave doganore për Emigracionin dhe Kontrollin e Kufijve,janë të strukturave përkatëse dhe kryesishtë MB (Drejtoria e Refugjatëve edhe Emigracionit,Drejtoria e Policisë Kufitare), MF (Doganat) dhe MPJ (mardhëniet ndërkombëtare) aktiviteti i cilave bazohet dhe në konventat ose marrëveshjet ndërkombëtare.Me shpalljen e gjendjes së emergjencës civile,përgjegjësinë për koordinimin e strukturave të mësipërme e ka KKECK (Komisioni Koordinues i E.C e Krizave).

Shërbimi shëndetësor parësor.

Drejtoritë e Shendetit Publiik,Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor janë përgjegjëse për sigurimin e shërbimit të urgjencës dhe Shërbimin Shëndetësor Parësor; nëpërmjet 1 poliklinike e cila është funksionale.Kërkesat

dhe nevojat koordinohen nga QOQEC, QKOEC në bashkëpunim me drejtuesit e bashkisë.

Shërbimi shëndetësor dytësor dhe tretësor.

Shërbimi Shendetësor Dytësor dhe Tretësor shtë në përgjegjësinë e Drejtorisë të Spitalit Rajonal Dibër. Për shërbime të specializuara mundë të kërkohe në Qendrat Spitalore Tiranë.Kapacitetet shtesë mundë të sigurohen nga MB.Kërkesat dhe nevojat koordinohen nga Drejtuesi i Operacioneve (QOQEC, QKOEC).

Menaxhimi i të dëmtuarve / viktimave në masë.

Menaxhimi i viktimave dhe të dëmtuarve në masë, konsiderohet një numër më i madh të dëmtuarish dhe viktimash se sa mundësitë e sistemit shëndetësor të përballojë në kohë normale. Menaxhimi i viktimave dhe të dëmtuarve në masë në momentet e para drejtohet nga strukturat e para reaguese, të cilat janë zakonisht forcat operacionale me të afërta në vendin e ngjarjes. Në varësi të vendit Triazhi dhe Ndihma e Parë bëhet nga strukturat e Shërbimit Shëndetësor (Spitali rajonal,qendrat shëndetësore) të MSH, të mbështetura nga MM, PSH, MAS (Fakulteti i Mjeksisë), SHMZSH, KKSH dhe vullnetarëve të kualifikuar nga sektori privat.

Evakuimi i të dëmtuarve për në shërbimin dytësor dhe tretësor është përgjegjësi e SHU të Drejtorisë të Spitalit Rajonal Dibër dhe qendrave shëndetësore të bashkisë. Kapacitetet përforcohen nga Drejtoria e Policisë (komisariti i policisë në rreth), organet e qeverisjes vendore, forcave speciale të MB, të grupeve të shpëtimit të MM, për evakuimin dhe transportin special të urgjencës dhe KKSH. Për identifikimin dhe menaxhimin viktimave në masë përgjigjen Pushtetit vendor, Strukturat e Policisë dhe MRRTT (Ministria e Rregullimit të Teritorit e Turizmit).

Sigurimi i Shërbimit të Shëndetit Publik

Drejtoritë e Shëndetit Publik, Drejtoria Kujdesit Shëndetësor Parësor kanë përgjegjësinë për monitorimin cilësisë të ujit të pijshëm dhe higjenës dhe për Programin e Zgjeruar të Vaksinimit dhe sistemin përkatës monitorues të situatës epidemiologjike edhe nga MSH.

Sigurimi dhe rivendosja në funksionin e shërbimeve jetike

Sigurimi i burimeve alternative me ujë të pijshëm duke përfshirë furnizimin me autobotë dhe të amballazhuar dhe riparimi i sistemit të furnizimit me ujë është përgjegjësi e MRRTT, e cila e realizon nëpërmjet strukturave të saj, ndërmarrjeve në nivel lokal, bashkëpunimit me organet e pushtetit vendor dhe të kontraktuarit që kryejnë këto shërbime, mbështetur dhe nga MM.

Sigurimi i burimeve alternative të energjisë dhe riparimit të sistemit të furnizimit me energji elektrike, është përgjegjësi e OSSHE (agjensive të rretheve), nëpërmjet grupeve të përgjigjes së menjëhershme (grupet eliminimit të avarive) e mbështetur nga strukturat e OSEE, OSSHE, Drejtoria e Tensionit të Lartë për riparimin prodhimin dhe transmetimit të energjisë dhe organet e pushtetit vendor.

Spektori privat ka përgjegjësinë për stacionet në pronësi të tyre për masat e sigurisë dhe të furnizimit me gaz. Spektori privat ka përgjegjësi për sigurimin dhe shpërndarjen e lëndës drusore për ngrohje mbështetur nga organet e pushtetit vendor.

Evakuimi i popullsisë në bashki është përgjegjësi e kryetarit të bashkisë / njësisë.

Gjatë situatave të emergjencës, forcat operacionale në terren (PSH, Stacionet e SHMZSH-së, mund të vendosi evakuimin e menjëhershëm për terriore të kufizuara. Në varësi të situatës rol të rëndësishëm luajnë masat që duhen marrë për të levizur në zona të sigurta.

Sigurimi i digave, pritave, kanaleve, lumenjve, liqeneve.

Përgjegjësia për kontrollin, mirëmbajtjen, sigurinë dhe riparimin e digave, dambave, pritave, kanaleve, liqeneve etj, është e ndarë nëpërmjet institucioneve si vijon:

MRRT, Sekretariati Teknik i Komitetit Shtetëror të Ujit (basena tujëmbledhës duke përfshirë liqenet, lumenjtë dhe pritrat në lumenj) Sekretarita Teknik i Komitetit të Digave të Larta (digat, rezervuaret)

Mbështetja teknike sigurohet nga:

Kryetari, drejton Këshillin e Basenave Ujëmbledhës dhe organizatat përgjegjëse për sistemet e kanalizimeve dytësore dhe tretësore në nivel lokal në bashkëpunim me MBU dhe autoritetin e bashkisë / njësisë.

Mbështetje me mjetet dhe paisje të rënda, nëse është e nevojshme, sigurohet nga MM, MBU, sektori privat.

Shoqata e Fermerëve Përdorues të Ujit. Kontraktorët shfrytëzues të burimeve ujore dhe rezervuareve.

Identifikimi dhe Sigurimi i Vendstrehimeve të Përkohëshme:

Caktimi i objekteve dhe rajoneve për sigurimin e vendstrehimeve të përkohëshme të sigurt, drejtohet nga autoriteti i bashkisë / njësisë, Prefekti dhe Këshilli i Qarkut, të mbështetur nga Drejtori i AKMC / DQO në nivel kombëtar. Ndhimë jepet nga ministritë dhe strukturat që kanë kapacitete në ndërtesa apo terrene për vendstrehim të përkohëshme, ku përfshihen: Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, (MKRS), MASH, MM, MB (DRSH), Ministria e Drejtësisë (MD) (evakuimi dhe strehimi i personave të paraburgosur dhe të burgosur) dhe KKSH.

Menaxhimi i artikujve të ndihmës emergjente nga burime të brendshme dhe ndërkombëtare

Bashkërendimi i furnizimit, transportit, magazinimit dhe shpërndarjes të artikujve të ndihmës kombëtare dhe ndërkombëtare, bëhet nga DQO/AKMC.

Sigurimi dhe furnizimi me artikuj të ndihmës bëhet nga: MBZHRAU, Ministria e Ekonomisë (ME), MM, MBMSH dhe KKSH.

Shpërndarja e ndihmës bashkërendohet nga DQO/AKMC në nivel kombëtar dhe në nivel lokal nga qark dhe organet e pushtetit vendor, në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e MSH (për ndihmën në ilaçe), strukturat e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale (MPÇS), (Drejtoria Rajonale e Punës), vullnetarët e KKSH dhe kontraktorët.

Shërbimet e ndihmës Sociale:

MPÇS (Drejtoria Rajonale e Punës) merr rolin bashkërendues në lidhje me çështjet e ndihmës sociale. Përvlerësimin e nevojave, identifikimin e me të prekurve dhe hartimin e zbatimit të asistencës sociale të nevojshme ajo punon ngushtë me organet e pushtetit vendor. Në punën e saj ajo asistohet nga Prefekti (zyra e shërbimeve koordinimit) dhe nga Degët e KKSH në bashki.

Rançija e Sigurisë dhe e Rendit Publik:

Për situatë të jashtëzakonshme problemet e sigurisë drejtohen nga Presidenti i Republikës këshilluar nga Këshilli Kombëtar i Sigurisë dhe mbështeten nga MPB (PSH), MM, Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe autoritetet në nivel bashkie.

Në fatkeqësi të mëdha: përgjegjësia e përgjithshme është e KKECK., nëpërmjet MPB (PSH) dhe ndihmuese MM si dhe autoritetet në nivel bashkie nëpërmjet strukturave të tyre policore.

Mbështetja financiare e emergjencës në të gjitha nivelet shtetërore.

Fondin e emergjencave civile në buxhetin e bashkive dhe të Këshillit të Qarkut.

Shpërndarja dhe transmetimi i Informacionit Publik

Informimi i publikut është element thelbësor i njoftimit të hershëm, parapërgatitjes dhe këshillimit të

komunitetit. Informimi i publikut mund të luaj rol të rëndësishëm në shpëtimin e jetës së njerëzve dhe pasurisë së tyre në raste emergjencash civile. Qartësia, korrektësia dhe shpejtësia e dhënies së informacionit është shumë e rëndësishme në raste të emergjencave civile, e cila sigurohet në nivel qendror e lokal nëpërmjet njoftimeve periodike të QKOEK, QOECQ-në, zyrës së emergjencave civile dhe DOQ-së.

Çështjet financiare

Situatat e EC sjellin ndërlikime financiare afatshkurtër dhe afatgjatë. Organet e qeverisjes fondet i kanë të kufizuara. Problemet për përballimin e kostove financiare në fazën e përgjigjes dhe në vazhdimësi janë të strukturave qendrore që janë në emergjencë. Megjithatë masat duhet të jenë të planifikuara paraprakisht dhe të jenë të aplikueshme për strukturat dhe shërbimet e përfshira në zgjidhjen e çështjeve të emergjencave civile.

Në të gjitha organet e pushtetit vendor dhe strukturat duhet të ekzistojnë plane dhe marrëveshje në mënyrë që të mbulojnë automatikisht kostot për marrjen e mjeteve të transportit, shoferëve dhe karburantit, për të mundësuar vlerësimet e menjëhershme të situatës dhe përgjigjen e menjëhershme ndaj situatës emergjente.

Rimbursimi i menjëhershëm i shpenzimeve të personelit të emergjencave në fazën e parë të përgjigjes së menjëhershme.

Lidhja e kontratave ose marrëveshjeve paraprake në kohë të qetë që vihen në zbatim në kohë emergjencash civile.

Këto bëjnë të mundur lejimin e shërbimeve, psh, atë të makinerive të rënda që të kërkohen urgjentisht tek kontraktoret dhe pagesës që bëhet në një fazë të mëvonshme siç parashikohet në marrëveshje.

Sipas mundësive financiare është e nevojshme të parashikohen kostot e mundshme të përgjigjes ndaj emergjencave duke marrë për bazë përvojat e kaluara, stërvitjet stimuluese dhe të përfshihen në buxhetin vjetor në zë të veçantë. Për përdorimin e këtij fondi duhet krijuar akses në çeljen e tij dhe përdorimin në mënyrë sa më fleksibël në kohë emergjente.

Raportimet dhe vlerësimet :

Raportimet për situatën merren nga institucionet dhe strukturat e ndryshme dhe, për t'u njohësuar, në mënyrë që ato të pasqyrojnë të gjithë informacionin që kërkohet, formularet standarte të raporteve për situatën, dëmet dhe nevojat janë paraqitur në manualët e dërguara nga MM-ja dhe janë dërguar modelet nga zyra e EC të Prefektit të qarkut në të gjitha institucionet dhe organet e pushtetit vendor në qark, të cilët janë:

Formulari i njoftimit të parë.

Raporti i të dhënave të para për atkeqësinë.

Kërkesë për ministritë e linjes për raste emergjente.

Formularët e vlerësimit të menjëhershëm të nevojave dhe dëmeve që jepen në manualët e emergjencave civile, janë mjete praktike, nëpërmjet të cilave merret informacion për nevojat e menjëhershme dhe dëmet e shkaktuara, për plotësimin e të cilit duhet të kontribuojnë në mënyrë aktive të gjithë autoritetet përkatëse. Formulari i raportit të të dhënave të para për fatkeqësinë duhet të përgatitet nga grupet e përbashkëta të vlerësimit. Sidoqoftë, para kësaj, nga ana e Prefektit (Zyra e EC) dhe i drejtuesve të bashkive (drejtuesit i EC), duke përdorur të njëjtin format, çdo kontribut i mundshëm është mjaft i

rëndësishëm. Në situatë të tejshkajshme, mund të bëhen ndërhyrje të menjëhershme paraprake (si: evakuimi në masë i popullsisë, operacione kërkim-shpëtimi, dhënia e ndihmës mjekësore dhe aktivite të tjera prioritare përpara ose gjatë bërjes së vlerësimit të nevojave.

Vlerësime të tjera pasuese do të bëhen, duke përdorur të njëjtën metodologji dhe menyrë pune, por më të detajuara në bazë të informacioneve të grumbulluara.

Rikthimi në gjendjen normale

Rikthimi në gjendjen normale përkufizohet si:

Tërësia e të gjithë masave për të siguruar që jeta dhe prona e komunitetit të prekur të rivendoset në të njëjtin nivel si edhe përpara situatës së emergjencës civile.

Çështjet e rikthimit në gjendjen normale trajtohen në ligjin nr. 45, të datës 18.07.2019, në të cilin faza cilësohet me termin “riaftësim” dhe nënkupton masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin në gjendjen e mëparshme të rajonit (territorit) të prekur nga fatkeqësia”.

Megjithëse faza e rikthimit në gjendjen normale vjen pas fazës së përgjigjes, ajo është gjithashtu e lidhur ngushtë me fazën tjetër të ciklit të emergjencave, parandalimin dhe lehtësimin dhe në këtë mënyrë mbyllet cikli i menaxhimit të emergjencave.

Faza e rikthimit në gjendjen normale është zakonisht koha për të promovuar veprimet e lehtësimit, për të kërkuar në mënyrë aktive mbështetjen për aktivitetet e këtij procesi në të ardhmen, sepse kujtesa e pasojave të emergjencës është ende e freskët për të gjithë komunitetin e prekur dhe strukturat e përfshira. Rikthimi në gjendjen normale është gjithashtu edhe një kohë për të vlerësuar efektivitetin e planeve të emergjencave dhe të veprimeve të ndërmarra në kuadër të përgjigjes. Rikthimi në gjendjen normale:

Fillon nga momenti i deklarimit të përfundimit të situatës së emergjencës civile, por që mund të duhen ditë, muaj ose vite për të relizuar rikthimin e plotë në normalitet. Ka raste negative kur rikthimi i plotë në gjendjen normale nuk mund të bëhet si rezultat i humbjes së jetëve të njerëzve, gjesë së gjallë ose ku objektet e banimit dhe infrastruktura e shkatërruar nuk mund të ndërtohen më. Për këtë arsye, çështjet e rikthimit në gjendjen normale kanë nevojë për angazhime afatshkurtëra dhe afëtgjata zhvillimi.

Largimi dhe zvogëlimi i rreziqeve direkte :

Vlerësimi teknik dhe informacioni i saktë është i domosdoshëm për t’u siguruar që rreziku i ardhur si rezultat i ç’faqjes së dukurive që shkakton situatën e emergjencës civile, nuk është më evident ose intensiteti i tij është zvogëluar deri në nivele të pranueshme dhe të sigurta. Gjithashtu, vlerësimi dhe informacioni janë me rëndësi të veçantë për konstatimin se nuk ka tregues të kthimit të menjëhershëm në nivelet e intensitetit të mëparshëm të rrezikut. Në varësi të dukurisë së mundshme të rrezikut në fjalë, strukturat monitoruese, etj, luajnë role të rëndësishme për të luajtur në vlerësimin e rreziqeve, për të bërë analizën, për të mbajtur dhe për të ruajtur lidhjet e tyre me institucionet rajonale shkencore.

Këto informacione duhet të plotësohen dhe të krahasohen nga vëzhgimet dhe të dhënat e mbledhura dhe të analizuar nga strukturat e emergjencave civile në zonat e prekura.

Këtu përfshihet informacion rreth:

Nivelit të ujrave në lumenj, rezervuare, në kanale dhe në zonën e përmbytur.

Treguesve për reshjet dhe prurjet.

Shpejtësisë së erës lokale/llojeve të drejtimit

Ndryshimeve lokale të temperaturës

Monitorimit të objekteve dhe të terreneve të cilat përbëjnë rrezik potencial. Nivelit dhe shpeshtësisë të goditjeve sizmike pas asaj kryesore, etj.

Stabilizimi i pasojave që vijnë nga burime dytësore rreziku.

Stabilizimi i çdo dukurie dytësore të rrezikut të mundshëm është thelbësor për të siguruar rikthimin në gjendje normale. Vlerësimet e veçanta teknike si dhe konsultat janë të nevojshme për t'u bërë nga strukturat që kanë ekspertizë dhe kompetenca të vecanta, për të arritur rezultate në vlerësimin e dukurive dytësore të rrezikut.

Strukturat e specializuara përfshijnë :

Drejtoria Bujqësisë

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (Kontrollin e produkteve ushqimore, shërbimet veterinare).

Inspektoriati Shtetëror i Pyjeve, Ujërave dhe Mjedisit

Autoriteti Rrugor Shqiptar Rajoni Qëndror (Rrugët nacionale).

Njësitë e Qeverisjes Vendore

Drejtoria e Shëndetit Publik,

Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor,

Spitale, Shërbimi Farmaceutik etj.

Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut (Salla Operacionale të Emergjencave, Policinë e Rendit, Policinë Rrugore, Forcat e Ndërhijes së Shpejtë).

Agjensia Rajonale e Mjedisit

OSHEE (Afhensitë Elektrike në rrethepër furnizim-shpërndarjen e energjisë elektrike, etj.)

Zyrën Vendore Arsimore (Për edukimin në sistemin arsimor dhe objektet shkollore).

Strukturat e dëmtuara dhe të shkatërruara.

Pajisjet dhe strukturat ndërtimore, infrastrukturore të shkatërruara, si dhe ato të dëmtuara që janë përtej mundësive për t'u riparuar menjëherë, janë sfida të pashmangshme në fazën e rikthimit në gjendjen normale. Kjo do të thotë që një pjesë e popullsisë nuk do të mund t'u kthehet menjëherë kushteve normale të jetës ose punës.

Këtu mund të përmendim zonat e shkatërruara nga zjarret ose toka bujqësore të përfshira nga përmbytjet apo të mbushura me aluvione. Niveli iu lë ti sigurojë banesat pranë institucioneve përkatëse, nënkupton që pas ndodhjes së një emergjence civile, si rezultat i së cilës dëmtohen një numër i madh banorësh, banorët e dëmtuar janë në vartësi vetëm të asistencës shtetërore ose të asaj humanitare.

Për rikthimin në gjendjen normale, kërkohet marrja e masave si më poshtë:

Këshillimi.

Sigurimi i informacionit të nevojshëm dhe këshilla për banorët që ekanë të pamundur kthimin në shtëpitë apo në zonat e tyre të banimit.

Strehimi. Sigurimi i burimeve të nevojshme për strehimin e menjëhershëm dhe në vazhdimësi të

popullsië, derisa të gjendet një strehim i përhershëm.

Asistenca.

Sigurimi i asistencës së vazhdueshme derisa banorët, grupet apo komuniteti i prekur të jetë në gjendje të fitojnë një masë sigurie dhe besimi në vetvete.

Rindërtimi.

Sigurimi i të gjitha hapësirave të mundëshme për gjetjen e materialeve të ndërtimit dhe të shërbimeve, atje ku rindërtimi ose ndërtimi i pjesëshëm është i mundur.

Shembja.

Sigurimi i kushteve të tilla që ndërtesa të dëmtuara apo pjesërisht të shkatërruara që përbëjnë rrezik, të mund të bëhen të sigurta apo të shemben fare, nëse është e nevojshme.

Zhvendosja.

Atje ku kthimi nuk është i mundur të sigurohet, dhënia e të gjitha mjeteve të mundëshme për të zhvendosur banorët në një vendbanim më të përshtatshëm, të sigurtë, nga të njëjtat shkaqe rreziku ose rreziqe që mund të shkaktojnë emergjenca civile të ngjajshme me to.

8. RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT.

Për referencë “Projekti PRONËS” dhe fushata “Unë nuk rrezikoj”.

9. FJALOR


Rrezik (H) është mundësia e ndodhjes së një fatkeqësie, me pasojë humbje të jetës, lëndime ose pasoja tjera shëndetësore, dëmtim të pronës, humbje të mjeteve të jetesës.

Vulnerabiliteti (V) tregon karakteristikat dhe rrethanat e një Komuniteti, sistemi i kanalizimeve, rrjeti i ujë të pijshëm, pasuria etj. Që i bën ata të ndjeshëm ndaj një fatkeqësie.

Ekspozimi (E) i njerëzve, kafshëve apo pasurive ndaj një fatkeqësie të mundshme.

Zonat e Riskut Natyror, janë ato zona ku mundësia e ndodhjes së një fatkeqësie është e lartë, si tokat pa bazament të fortë (të rrëshqitshme), zona me sizmitet të paqëndrueshëm etj.

Grupi i punës për ripunimin e këtij dokumenti :

- Specialiti Drejtorisë PPECK	Ramazan	TEMA	Kryetar	
- Specialiti Drejtorisë PPECK	Ilir	KCNIA	Anëtar	
- Specialiti Drejtorisë PPECK	Mario	SELISHTA	Anëtar	

FORMATET E RAPORTEVE DHE TË KËRKESAVE

SHKURTESAT

AKMC	- Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
DPPECK	- Drejtoria e Mbrojtjes Civile dhe Krizave
KKECK	- Komisioni i Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave
EC	- Emergjencat Civile
FM	- Fatkeqësi e Mundshme
FSO	- Formularët Standart të Operimit
GOMF	- Grupi Operacional i Menaxhimit të Fatkeqësive
GP	- Grupi i Punës
PMRE	- Programet e Menaxhimit të Rrezikut
PPF	- Planifikimi dhe Përballimi i Fatkeqësive
PSO	- Protokollet Standarte Operacionale
PVF	- Plani i Veprimit ndaj Fatkeqësive
QOMF	- Qendra Operacionale e Menaxhimit të Fatkeqësisë
SMF	- Sistemi i Menaxhimit të Fatkeqësive
KVEC	- Komisioni Vendor i Emergjencave Civile
MPB	- Ministria e Punëve Brendshme
MM	- Ministria e Mbrojtjes
MSH	- Ministria e Shëndetësisë
OJQ	- Organizatë JoQeveritare
PKEC	- Plani Kombëtar i Emergjencave Civile
PPKECKQ	- Plani i Përballimit dhe Koordinimit të E. C. Krizave në Qark
RRF	- Reduktimi i Rrezikut të Fatkeqësive
QO	- Qendrat Operative
KKSH	- Kryqi i Kuq Shqiptar
DRBU	- Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
AKU	- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (Kontr. e produkteve ushqimore shërbimet veterinare).
ARRSHRQ	- Autoriteti Rrugor Shqiptar, Rajoni Qendror.
DSHP	- Drejtoria e Shëndetit Publik,
DKSHP	- Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor,
SHF	- Shërbimimi Farmaceutik etj.
DVPSH	- Drejtoria Vendore e Policisë së Shtetit
OSHEE	- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
DRA	- Drejtoria Rajonale Arsimore
SDMECK	- Strukturat e Drejtimit dhe të Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Krizave
KKECK	- Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave
ZOS	- Zyra Operacionale e Situatës
GTK	- Komisioni Teknik Këshillimor
ZIMEK	- Zyrat e Informacionit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Krizave

DPPSH	- Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë së Shtetit
DPRMS	- Drejtoria e Përgjithëshme e Rezervave Materiale të Shtetit
DPMZSH	- Drejtoria e Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin
IKMT	- Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ()
ARRSH	- Autoriteti Rrugor Shqiptar
DPD	- Drejtoria e Përgjithëshme Detare
DPUK	- Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve
AAC	-Autoriteti i Aviacionit Civil
IFBZ	-Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
SHGJSH	-Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
AKB	-Agjensia Kombëtare Bërthamore
RISHM	-Reparti i Inspektim dhe Shpëtim Minierave
DRB	-Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
DRBK	-Drejtoria Rajonale e Bordit të Kullimit
AKU	-Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
ISUV	-Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
AKT	-Agjensia Kombëtare e Turizmit
AKB	-Agjensia Kombëtare e Bregdetit
ISHP	-Instituti i Shëndetit Publik
ZMR	-Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet
ISHMPAU	-Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit,Pyjeve dhe Administrimit të
UjraveARM	-Agjensia Rajonale Mjedisore
AKZM	-Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
AUB	-Agjensitë e Ujit dhe Baseneve
QNOD	-Qendra Ndërinstitucionale Operacionale
DetareDPB	-Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
IGJEUM	-Instituti i Gjeoshkencave,Energjisë,Ujit dhe Mjedisit
RRF	-Reduktimi i Rriskut të Fatkeqësive